



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: TRASHËGIMIA KULTURORE VIRTUALE**

**Pedagogu:** PhD.c. Rrapo Zguri  
**Ngarkesa:** 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)  
**Lloji i lëndës:** lëndë me zgjedhje  
**Programi i studimit:** Bachelor  
**Viti/Semestri:** I/I

**EKSTRAKT**

Interneti dhe Worl Wide Web kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën e prodhimit dhe të shpërndarjes së informacionit të fushave të ndryshme. Edhe informacioni i fushës së trashëgimisë kulturore (TK) është përfshirë tashmë në hapësirën e informacionit virtual, duke krijuar mundësi të reja për krijimin, promovimin dhe shpërndarjen e tij.

Lënda “Trashëgimia kulturore virtuale” synon të njohë studentët e nivelit Bachelor me kapacitetet që ofron interneti në lëmin e TK. Duke kombinuar njohjen teorike me zhvillimin e shprehive praktike të domosdoshme për një specialist të TK në epokën dixhitale, lënda i njeh studentët me atributet e Webit si menjëhershmeria, interaktiviteti, shtrirja globale, multimedialiteti, etj., dhe mënyrat se si këto attribute mund të përdoren në dobi të trashëgimisë kulturore.

Duke bërë një prezantim të potencialeve që ofron interneti për TK, lënda ofron njohuri teorike dhe praktike për krijimin website-ve të insitucioneve apo të objekteve të trashëgimise kulturore si dhe për përdorimin e kanaleve të tjera të shpërndarjes së informacionit online. Një vend i caktuar i kushtohet edhe përdorimit të mediave sociale, siç janë rrjetet sociale, blogjet, platformat e shpërndarjes së videos dhe të fotografisë, për krijimin e profileve institucionale dhe zgjerimin e audiencës së interesuar për informacioni e TK. Vëmendje e posaçme i kushtohet edhe menaxhimit të informacionit online të TK, pasurimit të tij në platformat Wikis, optimizimit të tij për arritjen prej motorëve të kërkimit, arkivimit dhe katalogimit të tij online, etj.

**TEMAT:**

**LEKSIONI 1:** Interneti dhe konteksti i tij social-kulturor

**LEKSIONI 2:** Hapësirat e internetit për informacionin e fushës së trashëgimisë kulturore

**LEKSIONI 3:** Atributet e webit dhe përdorimi i tyre në dobi të informacionit kulturor

**LEKSIONI 4:** Konceptimi i website-ve për objektet apo institucionet e trashëgimisë kulturore

**LEKSIONI 5:** Dizajnimi dhe ndërtimi i website-ve dhe blogjeve me platformën Wordpress.

**LEKSIONI 6:** Posta elektronike dhe përdorimi i saj për nevoja të TK

**LEKSIONI 7:** Rrjetet sociale dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore përmes tyre

**LEKSIONI 8:** Krijimi i profileve dhe faqeve insitucionale në rrjetet sociale (Facebook, Twitter)

**LEKSIONI 9:** Përdorimi i platformave video-sharing (YouTube) për nevoja të TK

**LEKSIONI 10:** Përdorimi i platformave photo-sharing (Flickr) për nevoja të TK

**LEKSIONI 11:** Trashëgimia kulturore virtuale në platformat Wikis (Wikipedia)

**LEKSIONI 12:** Praktika UGC (user generated content) dhe informacioni i TK

**LEKSIONI 13:** Informacioni i TK përmes pajisjeve mobile (tablet dhe smartphome)

**LEKSIONI 14:** Optimizimi i kërkimit të informacionit të TK në internet

**LEKSIONI 15:** Arkivimi dhe katalogimi online i informacionit të TK

**FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT****FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*10 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

**KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi I i pjesshëm në javën e 6-të (20% e notës përfundimtare)

**DETYRA E KURSIT:**

Detyra kursi: 1.Krijimi i websajtit të një insitucioni apo objekti të trashëgimisë kulturore, 2. Krijimi i profilit institucional në Facebook, 3. Krijimi i faqeve korresponduese në YouTube dhe Flickr

*30 % e notës përfundimtare*

**KONTROLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

**DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Realizim i detyrave praktike në web

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

**LITERATURA:**

1. Zguri, Rrapo, *Bazat e internetit dhe të komunikimit online*, cikël leksionesh
2. *Manual i ABC-së së internetit*, ISHM, Tiranë, 2010
3. Lorenzo Cantoni & Stefano Tardini, *Internet*, Routledge, 2006
4. Laura Lemay, *Web publishing*, Sams Publishing, 2010